

STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

AL-RO

Sot, më datë 23.11.2020 shoqëria “AL-RO” sh.p.k ,me seli Rruga “ Mustafa Matohiti”, Tirane , Nr pasurie 2/45-N3, ZK.8160, vol 10, faqe 196 , Njesi-N3 përfaqesuar nga Z.Roland Sino, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H80922038H themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “AL-RO” SH.P.K në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe këtë statut.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është AL-RO, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”)

NENI 2
THEMELIMI

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, Shqipëri.

NENI 3
SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “ Mustafa Matohiti”, Tirane , Nr pasurie 2/45-N3, ZK.8160, vol 10, faqe 196 , Njesi-N3

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë zyra dhe/ose të kryejë veprintari e biznese ne vende të tjera, qoftë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të administratorit të Shoqërisë.

Administratori mund të vendosë për të lidhur një kontratë qiraje për zyrën e regjistruar dhe/ose të ndryshojë selinë e regjistruar të Shoqërisë dhe të paraqesë vendimin përkatës pranë autoriteteve kompetente shqiptare. Nëse ky veprim kërkon një përditësim dhe ndryshimin e këtij nenit, me qëllim për të reflektuar adresën e re të selisë së regjistruar të Shoqërisë, administratori ka të drejtë dhe është i autorizuar për të marrë një vendim apo deklaratë të tillë.



NENI 4
OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është të ndërrmarrë çdo veprim ose aktivitet tregtar të ligjshëm për zhvillimin e të cilave një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të themelohet dhe regjistrohet sipas legjislacionit shqiptar i ndryshuar rast pas rasti. Veprimtaria e shoqerise do te kete per objekt:

- Shitje me pakice te frutave te thata,erezave dhe mallrave te tjera.

NENI 5
ORTAKËT DHE KAPITALI FILLESTAR

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njeqind) leke. Ky kapital eshte teresist I nenshkruar dhe I shlyer nga ortaket e saj. Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me vendim te asamblese se ortakeve. Kapitali themeltar perbehet nga kontributi I me poshtem

- 100 (njeqind) leke ose 100% te kapitalit themeltar.

Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar.

Përgjegjësia e Ortakeve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6
KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7
ORTAKËT

Ortaket e shoqerise jane :



-Shoqeria "Krik-Krak Shop" e rregjistruar me Nuis L91626001R dhe administrator Z.Roland Sino me nr identifikimi ID H80922038H pjesemarres ne shoqeri me numer pjesesh 51% te kapitalit.

-Dritan Shpata me numer identifikimi ID I30422179M , pjesemarres ne shoqeri me numer pjesesh 49% te kapitalit.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, ortaket mund të marrin vendime pa u kufizuar por vetëm si më poshtë:

- Përcaktimin e politikave të veprimtarisë së Shoqërisë
- Ndryshimi i Statutit
- Miratimin e bashkimit me shoqëri të tjera
- Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit
- Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertëve Kontabel
- Miratimin e skemës së kompensimit për Administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabel
- Mibkqyrjen e implementimit të politikave tregtare nga administratorët duke përfshirë mbikqyrjen e përgatijes së pasqyrave financiare dhe raporteve të aktivitetit
- Miratimin e raportit të administratorëve dhe pasqyrave financiare dhe cdo pasqyre tjetër brenda 6 muajve nga fundi i viti finanziar
- Shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve
- Riorganizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë
- Prishjen e shoqërisë dhe emërimin e likuidatorit/ëve
- Çështje të tjera të përcaktuara në statut

Mbledhja e asamblesë thirret nga Administratori përmes një njoftimi me shkrim për mbledhjen jo më pak se 7 dite përpëra ditës së mbledhjes. Në përputhje me ligjin asambleja duhet të thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme me shumicën e votime të ortakëve të pranishëm vetëm nëse janë të pranishëm ose përfaqësohen ortakët, të cilët përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 8 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Pronat, biznesi dhe punët e shoqërisë do të administrohen nga një administrator. Administratori i shoqërisë është Roland Sino, lindur më 22.09.1978, në Tirane mbajtës i leternjoftimit me numër personal H80922038H.



Shkarkimi ose zëvendësimi i administratorit do të bëhet me anë të një vendimi të ortakëve dhe shkarkimi apo zëvendësimi nuk do të konsiderohet si ndryshimin e këtij statuti dhe vendimi përkatës i ortakëve nuk është i nevojshmëm të reflektohet në statut.

- Mandati i administratorit do të jetë 5 vjet.
- Administratorit mund të shkarkohet në çdo kohë nga Ortaket.

Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por u kufizuar në sa vijon:

- Administrimi dhe kryerja e operacioneve të shoqërisë në Shqipëri, si dhe kryerjen e çdo veprimi që mund të jetë i nevojshëm për drejtimin e veprimtarisë së Shoqërise;
- Organizimi i operacioneve të Shoqërisë dhe kryerjen e këtyre operacioneve;
- Përfaqësimi i shoqërisë kundrejtë të gjitha subjekteve publike dhe/ose private, qoftë subjekte dhe/ose autoritete shqiptare apo të huaja;
- Nënshkrimi, hartimin e çdo dokumenti, duke përfshirë edhe ato financiare, hapja dhe/ose mbyllja e llogarive bankarë në emër të Shoqërisë, në monedhë të huaj dhe shqiptare, si dhe nënshkrimin, hartimin e çdo dokumenti në lidhje me këto llogari bankare, kryerjen e të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari bankare, kryerjen e të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari;
- Punësimin dhe shkarkimin e punëmarrësve në kuadër të politikavë të përcaktuara nga Shoqëria;
- Realizimi i çdo veprimi tjeter të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm administrativ për administrimin e Shoqërisë;
- Nënshkrimi dhe dorëzimi i deklaratave tatimore dhe të deklaratave të tjera dhe raporteve pranë Regjistrit Tregtar shqiptar dhe Zyrës së Tatimeve, si dhe pranë të gjitha organeve të tjera shtetërore të autorizuara dhe institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore ku kërkohet një dorëzim i tillë;
- Lidhjen, nënshkrimin dhe kryerjen e çdo transaksi (duke përfshirë shitjen dhe blerjen e pasurive të paluajtëshme), pa asnjë kufizim vlere;
- Kryerjen e të gjitha akteve të tjera, veprimeve dhe çështjeve për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.
- Administratori mund të transferojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tij/tyre të administrimit të një pale të tretë dhe në çdo moment ata mund të anulojnë transferimin e këtyre kompetencave.

NENI 9 **EKSPERT(ET) KONTABEL TE AUTORIZUAR**

Eksperti kontabël të autorizuar do të emërohet me vendim të Ortakeve në rast kur ajo kërkohet nga legjislacioni shqiptar apo kur Ortakët e konsiderojnë të nevojshme.



NENI 10
VITI USHTRIMOR

Viti Ushtrimor fillon në 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përjashtimisht, viti i parë ushtrimor fillon me datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe përfundon me datë 31 Dhjetor të atij viti.

NENI 11
SHPERNDARJA DHE PRISHJA

Likujdimi dhe emërimi i likujdatorit kryhet në përputhje me legjisacionin shqiptar.

NENI 12
LIGJI I ZBATUESHEM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me aplikimin ose interpretimin e këtij Statuti do të zgjidhet pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

NENI 13
NDRYSHIMET

Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të ortakëve.

ORTAKET E SHOQERISE

KRIK –KRAK SHOP



DRITAN SHPATA

